



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.417/1 Prot.

Tiranë, më 23. 04.2024

V E N D I M

Nr. 105, Datë 23.04.2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, mori në shqyrtim ankesën Nr.30 Regj, datë 07.03.2024, paraqitur nga një grup personash: Xh.A, M.Ç, R.O, E.Xh dhe E.M kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit ankuesit Xh.A, M.Ç, R.O, E.Xh dhe E.M, kanë parashtruar si vijon:

“Jemi një grup studentësh dhe të rinj gjimnazistë nga Rajoni i Korçës. Në muajin shtator 2023 kemi qenë pjesë e takimit “Laboratori i Demokracisë-Rajoni Korçë”, projekt i zbatuar nga “Gruaja në zhvillim Korçë” mbështetur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) dhe financiar me fondet e Qeverisë Suedeze, ku jemi njohur me LMD nga përfaqësuesja e Zyrës Rajonale të Komisionerit në Korçë. Gjatë takimit janë diskutuar problematika të ndryshme. Një ndër problematikat shqetësuese për të rinjtë që vazhdojnë shkollën e mesme të përgjithshme është edhe marrja e teksteve shkollore e cila rëndon tepër buxhetin e prindërve. Këtë fenomen e kemi hasur dhe ne kur kemi qenë në bankat e shkollës së mesme dhe kemi ndjerë që kishte një shkelje dhe diskriminim për ne pasi nuk trajtoheshim njësoj si bashkëmoshatarët tanë të cilët ishin në shkollat profesionale.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ne si studentë kemi qenë pjesë e këtyre gjimnazistëve dhe me të drejtë shqetësimi i ngritur nga të rinjtë që vazhdojnë aktualisht shkollën e mesme të përgjithshme është plotësisht i vërtetë, pasi shohim një diskriminim që i është bërë kësaj kategorie.

Shohim që një kategori e caktuar këto tekste i merr falas, kurse pjesa tjetër jo. Ne si grup studentësh dhe të rinj që vazhdojmë gjimnazin pretendojmë që këtu ka një veçim dhe diskriminim për pjesën tjetër, e cila nuk është përfituese nga këto kategori që janë të përfshira në VKM. Gjithashtu shohim që nxënësit që studiojnë në shkollat profesionale kanë më tepër “benefite” se ata që vazhdojnë studimet në shkollë të përgjithshme. Pse duhet ky diferencim për ta? Dimë që politikat e shtetit janë më tepër favorizuese që nxënësit të drejtohen drejt arsimit profesional, pasi në ditët e sotme ata kërkohen më tepër në treg, por të mos harrojmë që ne si nxënës të arsimit të përgjithshëm studiojmë dhe kemi të njëjtat të drejta si çdo i ri që jeton në territorin e Republikës së Shqipërisë. Marrja e teksteve shkollore ka një kosto tepër të lartë dhe është shumë e vështirë që familjet tona ta përballojnë pasi të ardhurat mujore janë në pagën minimale ose dhe më pak. Nëse ne drejtohemi të gjithë tek këto shkolla profesionale për të përfituar nga politikat e shtetit, nuk duhet të harrojmë që në një të ardhme nuk do të ketë studentë që mund të drejtohen në ato degë që janë të kërkuara në treg, si mjekësi, ekonomik, IT, mësues etj.

Nuk kërkojmë që atyre t’u hiqet kjo e drejtë, por duam që dhe ne nxënësit të ndjekim arsimin në sistemin e mesëm të përgjithshëm të kemi këto përfitime, pra të marrim tekstet shkollore falas dhe të jemi përfitues të politikave lehtësuese që zbatohen për nxënësit e shkollave profesionale. nëse shohim numri i shkollave profesionale është më i madh se ai i gjimnazeve. Ashtu si në sistemin 9 vjeçar që shteti ndryshoi VKM në përfitimin e teksteve shkollore falas të bëhet dhe për sistemin e mesëm.”

Përfundimisht ankuesit kërkojnë nga Komisioneri, hetimin e rastit dhe rekomandimin për ndryshim VKM në marrjen e teksteve falas për gjimnazet e përgjithshme.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në kuadër të shqyrtimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankesa nuk ishte e plotë, kryesisht për sa i përket dokumentacionit nëpërmjet të cilit provohet statusi i ankuesve si studentë dhe/ose gjimnazistë, sikurse parashtrohet prej tyre në ankesë. Nëpërmjet e-mailit të datës 20.03.2024, ankuesve iu kërkua plotësimi i ankesës me dokumentacionin që provon statusin e pretenduar prej tyre.

Me anë të e-mailit të datës 12.04.2024, nëpërmjet personit të identifikuar në formularin e ankesës si person kontakti, ankuesve iu është dërguar rikujtesë për plotësimin e ankesës brenda datës 19.04.2024.

Në vijim të njoftimit të mësipërm, ankuesit nuk e plotësuan ankesën me dokumentacionin e kërkuar.

Në nenin 1, të LMD përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore** ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 4, të ligjit LMD, përcaktohet se: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Bazuar në nenin 32, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”;

Bazuar në nenin 33, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe mbështetur në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga ankuesit, Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” të LMD, ku përcaktohet se: ““4.Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.....””, ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet si e papajtueshme me dispozitat e ligjit, për arsyet e mëposhtme:

Bazuar në nenin 4, të LMD të marrë së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, janë subjekte të ligjit dhe mund t’i drejtohen Komisionerit të gjithë personat fizikë dhe juridikë, si dhe çdo subjekt i së drejtës i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 32/a dhe 33/1, të LMD” i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose organizate me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, për të paraqitur ankesë para Komisionerit. Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që një person ose grup personash të kenë një interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative. Pra në rastin konkret, që ankuesit të legjitimohen si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të kenë një interes legjitim të drejtëpërdrejtë.

Ankuesit pretendojnë se, nxënësit të cilët ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm diskriminohen për shkak të gjendjes arsimore, në raport me nxënësit që ndjekin shkollat e mesme profesionale, për shkak se, ndryshe nga këta të fundit, nuk përfitojnë tekste falas. Në këto kushte, për t’u legjitimuar për të paraqitur një ankesë pranë Komisionerit, ankuesit duhet të provojnë se cenohen në interesin e tyre legjitim të drejtëpërdrejtë. Pra, ankuesit duhet të provojnë se cenohen duke mos përfituar tekste falas në raport me nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm profesional.

Për të vlerësuar nëse ankuesit legjitimohen për të paraqitur ankesën pranë Komisionerit dhe për të provuar se për shkak të diferencës në trajtim që bëhet midis nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atyre që ndjekin arsimin e mesëm profesional, ata duhet të provojnë se janë aktualisht nxënës që ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe për shkak të trajtimit të diferencuar në raport me nxënësit që ndjekin arsimin profesional, ata janë vendosen në pozita diskriminuese.

Komisioneri iu kërkoi në mënyrë të përsëritur ankuesve që të depozitonin dokumentacionin e nevojshëm që provonte statusin e tyre si student dhe/ose gjimnazist, duke ju lënë në dispozicion edhe një afat të arsyeshëm për t’u pajisur dhe për të depozituar dokumentacionin e kërkuar. Ankuesit nuk e plotësuan ankesën me dokumentacionin e kërkuar.

Në parashtrimet e tyre ankuesit shprehen se janë një grup të rinjsh studentë dhe gjimnazistë. Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, përpos faktit se nuk u administruan prova që provojnë statusin e

secilit prej ankuesve si studentë dhe/ose gjimnazistë, Komisioneri thekson se, për ata ankues të cilët kanë statusin e studentit, problematika e paraqitur, pavarësisht se mund të vazhdojë të jetë prezente, në momentin e paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi, ata nuk janë më subjekte të cilët cenohen në interesin e tyre legjitim të drejtëpërdrejtë, pasi nuk janë më gjimnazistë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesit nuk provuan se ata kanë një interes legjitim të drejtëpërdrejtë për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi dhe rrjedhimisht ata nuk legjitimohen për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 1 dhe pika 4, gërma “b”, nenin 33 pika 10 të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me Nr.30 Regjistri, datë 07.03.2024, të paraqitur nga ankuesit Xh.A, M.Ç, R.O, E.Xh dhe E.M kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, për shkak se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja arsimore
Fusha: Arsim
Lloji I vendimit: Mospranim/mungesë legjitimimi aktiv